

4
i dërguar A.K.
she A.A.
12.06.2006
nr. Prot 161/30

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 344, datë 7.6.2006

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.459, DATË
23.9.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E
KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET", TË NDRYSHUAR,
DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 124 e 128, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të neneve 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 12, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2006", me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.459, datë 23.9.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë, i pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:


“ Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe 5 anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet propozohet nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe emërohet nga Kryeministri, ndërsa anëtarët e këtij komiteti propozohen nga kryetari dhe emërohen nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Emërimi i përbërjes së këtij komiteti bëhet në mbështetje të parimeve të asnjësisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, për të reflektuar identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.”.

2. Në fund të pikës 5 të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Numrit të përgjithshëm të punonjësve buxhetorë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i shtohet edhe një vetë. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, në titullin 086, t’i shtohet fondi prej 446 220 (katërqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e njëzet) lekësh, për përballimin e pagës së anëtarit shtesë. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI




SALI BERISHA

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE

BUJAR LESKAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI



SUZANA TURKU

NR.PROT.1681/1
DATE 9.6.2006

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

